



Pranuar / Dorezuar Punë/Prodato Received/Delivered	28.12.2023	3	viti god year
Organ /B pjesa Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Pislog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKANSACK	7716/2023		117



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1370/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, me Ilire Mehmeti-Shaqiri- Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1370/2023 të datës 02.11.2023 të parashtruar nga ankuesi \_\_\_\_\_, me adresë banimi Rr. "Xhevdet Berisha" Nr.11, kundër Vendimit me numër RN00012079/02 të datës 05.10.2023 të Komisionit të Pranimit në Komunën e Prizrenit, në çështjen juridike "kontestim konkursi, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 27.12.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.1370/2023 e datës 02.11.2023, e parashtruar nga ankuesi \_\_\_\_\_.

II. Mbetët në fuqi Vendimi me numër RN00012079/02 i datës 05.10.2023 i Komisionit të Pranimit në Komunën e Prizrenit, si dhe Njoftimi i datës 01.11.2023 i Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Komunën e Prizrenit.

A r s y e t i m

Komuna e Prizrenit duke u bazuar në dispozitat e nenit 34 paragrafi 2 dhe 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe nenit 7 dhe 9 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, me datën 14.07.2023 ka shpallur Konkursin për Pranim me numër reference RN00012079, për emrin e grupit "Specialist të Ekonomisë", për pozitën "Inspektor i tregut, me afat për aplikim nga data 04.08.2023 deri me datë 11.08.2023, dhe në të cilën procedurë pranimi ka qenë i përfshirë edhe ankuesi \_\_\_\_\_ (tutje vetëm ankuesi).

Ankuesi ka qenë i përfshirë në të gjitha fazat e vlerësimit të Konkursit me numër reference RN00012079, ndërsa i pa kënaqur me njoftimin për rezultatet e vlerësimit me numër protokolli \_\_\_\_\_.

Nr.RN00012079/02 të datës 01.11.2023 ku është renditet i dyti në listë, me gjithsejtë tetëdhjetë e tetë pikë dy (88) pikë të arritura, më datën 01.10.2023 ka parashtruar ankesë tek Njësia e Burimeve Njerëzore në Komunën e Prizrenit me pretendimet ankimore, se Komisioni i Pranimit nuk e ka bërë vlerësimin e drejtë ndaj ankuesit si dhe i njëjti ka propozuar që të anulohen rezultatet e shpallura sipas njoftimit të datës 29.09.2023.

Ndërsa Komisioni i Pranimit në Komunën e Prizrenit me Vendimin me numër protokollit NR.RN00012079/02 të datës 05.10.2023 i ka refuzuar si të pa bazuar ankesën e datës 01.10.2023 të ankuesit, me arsyetimin se Komisioni i Pranimit nuk ka gjetur prova relevante që ankesa e ankuesit të aprovohet.

Ankuesi i pa kënaqur me Vendimin me numër Nr.RN00012079/02 të datës 05.10.2023 të Komisionit të Pranimit dhe Njoftimit me numër Nr.RN00012079/02 01.11.2023, me datë 02.11.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 6834/2023 të në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore se Komisioni i Pranimit me rastin e refuzimit të ankesës së datës 01.10.2023 të parashtruar nga ankuesi, nuk ka aplikuar drejtë dispozitat ligjore, për shkak se në procedurë që i ka paraprirë aktit nuk është vepruar sipas rregullave të procedurës, nuk është vërtetuar drejte gjendja faktike apo nga faktet e vërtetuara edhe nxjerr konkluzion jo i drejtë në pikëpamje të gjendjes faktike, si dhe mos respektimi e Ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, më datë 09.11.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Prizrenit, ndërsa kjo e fundit me datë 20.11.2023 ka përcjell përgjigjen në ankesë me numër protokollit 1370/2023 së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Sipas kërkesës së anëtarëve të Kolegjit, me datë 14.12.2023 Kryetari i Këshillit ka nxjerrë Vendimin me shifër VK/2023 dhe numër protokollit:7490/2023, përmes së cilit ankesës së ankuesit A.nr.1370/2023 të datës 02.11.2023 ia ka vazhduar afatin vendimmarrës edhe për dhjetë (10) ditë pune.

*Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova:* Ankesën me numër të protokollit 6834/2023 të datës 01.11.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur mbikëqyrës për shërbim Civil të Kosovës; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 09.11.2023; Përgjigjen në ankesë të datës 20.11.2023; Konkursin me numër të referencës Rn00012079 të datës 14.07.2023 për grupin Specialist të Ekonomisë; Vendimin e datës 14.08.2023 për Themelimin e Komisionit të Pranimit; Njoftimin e datës 18.08.2023; Njoftimin e datës 23.08.2023; Njoftimin e datës 29.09.2023; Njoftimin e datës 01.11.2023; Vendimin e datës 05.10.2023 të komisionit të Pranimit; Listën e kandidatëve të pranuar; Dëftesën me numër 206/07; Certifikatën e datës 29.05.2002; Mirënjohjen e lëshuar nga Parlamenti i Studenteve në Universitetin e Prishtinës; Letër referencën e datës 27.07.2022 të lëshuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit; Vërtetimin e datës 01.02.2013 të lëshuar nga Drejtori i Al Estetika, Referencën e datës 28.02.2017 lidhur me përfundimin e punës praktike në "KAG Asphalt Company" në

SH.P.K; Vërtetimin mbi punësimin e datës 27.07.2022 të lëshuar nga Menaxheri i Burimeve Njerëzore në Agjencinë Kosovare të Privatizimit; Referencën e datës 02.08.2022 të lëshuar nga Menaxheri i Departamentit Rajonal për Konsumatorë në Hidroregjioni; Certifikatën e datës 09.05.2017; Diplomën me numër 157 të datës 19.10.2018 të lëshuar nga Universiteti "Ukshin Hoti" në Prizren me të cilën dëshmohet se ankuesi ka përfunduar studimet Master i Arteve në administrim dhe Biznesi; Diplomën me numër 93 të datës 22.10.2013 të lëshuar nga Universiteti "Ukshin Hoti" në Prizren me të cilën se ankuesi ka përfunduar studimet Bachelor i arteve në Menaxhimet ndërkombëtar; Dokumentin e identifikimit; Certifikatën e datës 09.08.2023 mbi dënimet penale; Pasqyrën e Llogarisë bankare- Trustin për periudhën kohore 17.03.2015 deri me datë 07.08.2023; Aplikacionin e datës 10.08.2023. Ndërsa kandidati i përzgjedhur N. Kadolli me rastin e aplikimit ka dorëzuar Diplomën me numër 87/14 të datës 22.08.2014; Diplomën me numër 82/16 të datës 24.10.2016; Certifikatën e datës 06.01.2003 lidhur me përfundimin e seminarit një ditor të lëshuar nga Kosova Children's Rights Center; Certifikatën lidhur me pjesëmarrjen në trajnimin katër-ditor për Mësimdhënien me Nxënësin në Qendër; Shkresën e datës 25.02.2008 lidhur me përfundimin e trajnimit ; Planifikimi i projekteve shkollore; Certifikatën me Nr.115/16 lidhur me përfundimin e programit "Ndërtimi i kapaciteteve të drejtoreve të shkollave për mision e qeverisjes, menaxhimit dhe udhëheqjes së shkollës "njëzet e një ditore"; Certifikatën e datës 17.12.2017 lidhur me përfundimin e trajnimit " Kontabiliteti dhe Trajnimet Praktike; Vërtetimin e datës 07.04.2016 lidhur me përvojën e punës së kandidatit në shkollën Sadri Dula në pozitën mësimdhënës për periudhën kohore dy vite e një muaj e njëzet e pesë ditë përvojë pune; Vërtetimin e datës 18.05.2022 me të cilën vërtetohet se kandidati është në marrëdhënie pune pran shkollës "Ekrem Rexha"; Vërtetimin e datës 15.06.2022 lidhur me përvojën e punës në "Panther" SH.P.K në pozitën e punës Menaxher i marketingut; Vërtetimin e datës 12.04.2023 lidhur me përvojën e punës në Kolegjin Biznesi në Prishtinë; Referencën e datës 12.04.2023 të lëshuar nga Kolegji Biznesi në Prishtinë; Referencën e datës 16.05.2022 të lëshuar nga ShMU, " Gani Saramati" në Prizren; Referencën e datës 24.12.2015 të lëshuar nga ShMU " Ekrem Rexha"; Certifikatën e datës 10.20.2020; Certifikatën mbi dënimet penale të datës 09.08.2023 të lëshuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës; Pasqyrën e Llogarisë Bankare Trustin për periudhën kohore 12.02.2008 deri me datën 07.08.2023, si dhe dokumentin e identifikimit. Emalin e datës 17.11.2023; Vendimin me numër të protokollit 7490/2023 të datës 14.12.2023;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës, konstatoi se ankesa e ankuesit \_\_\_\_\_, është e pabazuar, sepse:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave gjatë analizimit të shkresave të lëndës ka konstatuar, se Komuna e Prizrenit bazuar në dispozitat e nenit 34 paragrafi 2 dhe 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe nenit 7 dhe 9 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, me datën 14.07.2023 ka shpallur konkursin për praninë me numër reference RN00012079, për emrin e grupit "Specialist të Ekonomisë", për pozitën "Inspektor i Tregut" në kuadër të Drejtorisë për Inspektorat/ Sektori i Tregut, me afat për aplikim nga data 04.08.2023 deri me datë 11.08.2023, dhe ku si kërkesa të përgjithshme formale kanë qenë:

- *Arsimimi i kërkuar:* Diplomë/a e arsimit të lartë me së paku tri (3) vite të studimeve fakulteti Ekonomik.
- *Kualifikime te posaçme formale;* Certifikatën, licencën kur kërkohen me legjislacionin në fuqi apo kur vlerësohet se janë të nevojshme për pozitën e kësaj klase.
- *Përvoja e punës së kërkuar:* Së paku dy (2) vite përvojë pune profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës.

Komuna e Prizrenit me qëllim të fillimit të procedurave të pranimit, duke u bazuar në nenin 34, paragrafi 12 dhe 13 të Ligjit Nr.06/L-144 për Zyrtarët Publike, si dhe nenin 18 të Rregullores 16/2020 për Pranim dhe Karrierë në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, me datë 14.08.2023 ka nxjerrë Vendimin me Nr.RN00012079 për formimin e Komisionit të Pranimit për konkursin me numër reference RN000012079, për emrin e grupit "Specialist të Ekonomisë", për pozitën "Inspektor i Tregut" në kuadër të Drejtorisë për Inspektorat/ Sektori i Tregut.

Tutje në konkursin për pranim me numër reference RN RN00012079 për pozitën "Inspektor Tregut", në listë të ngushtë kane hyre gjashtëmbëdhjetë (16) kandidatë në mesin e tyre edhe ankuesi i cili ka qenë i përfshirë në gjithë procedurat e vlerësimit të konkursit për pranim për pozitën "Inspektor i Tregut", ku i njëjti është renditur i dyti në listën përfundimtare me gjithsejtë tetëdhjetë e tetë (88) pikë të përgjithshme .

Njësia e Burimeve Njerëzore në Komunën e Prizrenit me date 29.09.2023 ka publikuar njoftimin për shpalljen e rezultateve dhe kandidatit fitues, ndërsa me date 01.10.2023 ankuesi ka parashtruar ankesë pranë Komisionit të Pranimit në Komunën e Prizrenit kundër njoftimit të datës 29.09.2023. Ndërsa me date 05.10.2023 Komisioni i Pranimit ka marrë Vendimin me numër RN00012097/02 me të cilin ka refuzuar ankesën e ankuesit si të pa bazuar.

Ankuesi i pa kënaqur Vendimin me numër Nr.RN00012079/02 të datës 05.10.2023 dhe Njoftimin me numër Nr. RN00012079/02 të datës 01.11.2023 të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Prizrenit, lidhur me renditjen përfundimtare dhe zhvillimin e procedurave të konkursit për pranim për pozitën "Inspektor i Tregut", me datë 02.11.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me pretendimet ankimore se Komisioni i Pranimit me rastin e refuzimit të ankesës së datës 01.10.2023 të parashtruar nga ankuesi, nuk ka aplikuar drejt dispozitat ligjore, për shkak se në procedurë që i ka paraprirë aktit nuk është vepruar sipas rregullave të procedurës, nuk është vërtetuar drejte gjendja faktike apo nga faktet e vërtetuara është nxjerrë konkluzion jo i drejte në pikëpamje të gjendjes faktike, si dhe mos respektimi i Ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave, gjatë shqyrtimit të shkresave të lëndës ka konstatuar se si kandidatë i suksesshëm të Konkursit me numër Reference RN00012079, për pozitën "Inspektor i Tregut", në kuadër të Drejtorisë për Inspektorat/ Sektori i Tregut në Komunën e Prizrenit është përzgjedhur kandidati N.Kodolli me gjithsejtë 90.05 pikë të përgjithshme . Ndërsa ndërlidhur me pretendimin ankimor të ankuesit lidhur me vlerësimin e biografisë me 16 pikë i cili vlerësim ka ndikuar që ankuesi të mos jetë kandidat i përzgjedhur pasi që në testin me shkrim ka qenë kandidati me i vlerësuar me gjithsejtë 62 pike ndërsa në

intervistën me goje është vlerësuar me gjithsejtë dhjetë pike (10) pikë, Kolegji ka analizuar dosjen e ankuesit i cili me rastin e aplikimit ka dorëzuar, Dëftesat lidhur me përfundimin shkollës së mesme, Certifikatën e datës 29.05.2002; Mirënjohjen e lëshuar nga Parlamenti i Studenteve në Universitetin e Prishtinës, Letër referencën e datës 27.07.2022 të lëshuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit; Vërtetimin me e datës 01.02.2013 të lëshuar nga Drejtori i Al Estetika, Referencën e datës 28.02.2017 lidhur me përfundimin e punës praktike në "KAG Asphalt Company" në SH.P.K.; Vërtetimin mbi punësimin e datës 27.07.2022 të lëshuar nga Menaxheri i Burimeve Njerëzore në Agjencinë Kosovare të Privatizimit, Referencën e datës 02.08.2022 të lëshuar nga Menaxheri i Departamentit Rajonal për Konsumatorë në Hidroregjionin, Certifikatën e datës 09.05.2017, Diplomën me numër 157 të datës 19.10.2018 të lëshuar nga Universiteti "Ukshin Hoti" në Prizren me të cilën dëshmohet se ankuesi ka përfunduar studimet Master i arteve në administrim dhe Biznesi, Diplomën me numër 93 të datës 10.03.2015 të lëshuar nga Universiteti "Ukshin Hoti" në Prizren, me të cilën dëshmohet se ankuesi ka përfunduar studimet themelore me datë 28.10.2013 dhe ka marrë gradën Bachelor i arteve në menaxhimet ndërkombëtar; Dokumentin e identifikimit; Certifikatën e datës 09.08.2023 mbi dënimet penale; Pasqyrën e Llogarisë bankare- Trustin për periudhën kohore 17.03.2015 deri me datë 07.08.2023; Aplikacionin e datës 10.08.2023. Ndërsa kandidati i përzgjedhur me rastin e aplikimit ka dorëzuar Diplomën me numër 87/14 të datës 22.08.2014 të lëshuar nga Kolegji „ Biznesi “ në Prishtinë, me të cilën dëshmohet se ankuesi ka përfunduar studimet themelore me datë 03.07.2014 në programin Banka Financa dhe Biznes dhe ka marrë gradën Bachelor i arteve në Banka, Financa dhe Biznes ; Diplomën me numër 82/16 të datës 24.10.2016 të lëshuar nga Kolegji „ Biznesi “ në Prishtinë, me të cilën dëshmohet se ankuesi ka përfunduar studimet Master me datë 08.07.2016 dhe ka marrë gradën Master i arteve në Menaxhimet dhe Financa; Certifikatën e datës 06.01.2003 lidhur me përfundimin e seminarit një ditor të lëshuar nga Kosova Children's Rights Center; Certifikatën lidhur me pjesëmarrjen në trajnimin katër-ditor për Mësimdhënien me Nxenesin në Qendër; Shkresën e datës 25.02.2008 lidhur me përfundimin e trajnimit; Planifikimi i projekteve shkollë, Certifikatën me Nr.115/16 lidhur me përfundimin e programit "Ndërtimi i kapaciteteve të drejtoreve të shkollave për misionin e qeverisjes, menaxhimit dhe udhëheqjes së shkollës "njëzet e një ditore"; Certifikatën e datës 17.12.2017 lidhur me përfundimin e trajnimit " Kontabiliteti dhe Trajnime Praktike; Vërtetimin e datës 07.04.2016 lidhur me përvojën e punës së kandidatit në shkollën Sadri Dula në pozitën mësimdhënëse për periudhën kohore dy vite e një muaj e njëzet e pesë ditë përvojë pune; Vërtetimin e datës 18.05.2022 me të cilën vërtetohet se kandidati është në marrëdhënie pune pran shkollës "Ekrem Rexha"; Vërtetimin e datës 15.06.2022 lidhur me përvojën e punës në "Panther" SH.P.K në pozitën e punës Menaxher i marketingut; Vërtetimin e datës 12.04.2023 lidhur me përvojën e punës në Kolegjin Biznesi në Prishtinë; Referencën e datës 12.04.2023 të lëshuar nga Kolegji Biznesi në Prishtinë; Referencën e datës 16.05.2022 të lëshuar nga ShMU, " Gani Saramati" në Prizren; Referencën e datës 24.12.2015 të lëshuar nga ShMU " Ekrem Rexha"; Certifikatën e datës 10.20.2020; Certifikatën mbi dënimet penale të datës 09.08.2023 të lëshuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës; Pasqyrën e Llogarisë Bankare Trustin për periudhën kohore 12.02.2008 deri me datën 07.08.2023, si dhe dokumentin e identifikimit. Andaj kolegji i Këshillit pas analizimit të provave të dërguara nga organi i punësimit respektivisht aplikacioneve të dërguara nga kandidatet me rastin e aplikimit për grupin Specialist e Ekonomisë ka gjetur se pretendimi i ankuesit nuk është i bazuar pasi kandidati i përzgjedhur ka dorëzuar gjashtë certifikata për trajnime për të cilat edhe është vlerësuar dhe i ka arritur

gjithsejtë 19.5 pik, ndërsa ankuesi ka dorëzuar vetem nje cerifikate andaj Komisioni i pranimit me rastin e vlerësimit të jetëshkrimit për kandidatën e përzgjedhur dhe të ankuesit ka vepruar në pajtim me nenin 22 të Rregullores 16/2020 për Pranim dhe Karrierë në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës i cili përcakton se, *Vlerësimi i jetëshkrimit 1.Pas testimit me shkrim, vlerësimi i kandidatëve vazhdon me vlerësimin e jetëshkrimit. 2.Vetëm kandidatët që kanë marrë të paktën dyzet (40) pikë në testimin me shkrim, i nënshtrohen vlerësimit të jetëshkrimit. 3.Vlerësimi i jetëshkrimit konsiston në vlerësimin e cilësisë dhe nivelit të arsimimit, të përvojës domethënëse në punë dhe të trajnimeve që lidhen me vendin e punës në lëminë përkatëse të lidhur me Grupin për të cilët zhvillohet konkurimi. 4.Vlerësimi maksimal për jetëshkrimin është deri në njëzet (20) pikë, të ndara, si vijon: 4.1. deri në tetë (8) pikë për cilësinë dhe nivelin të arsimimit; 4.2. deri në shtatë (7) pikë për përvojën domethënëse në punë; dhe 4.3. deri në pesë (5) pikë për trajnimet, 5.secili nga anëtarët e Komisionit të Pranimit, bën vlerësimin e detajuar për secilën prej faktorëve të përcaktuara në pajtim me paragrafin 3 dhe 4 të këtij neni. Vlerësimi përfundimtar i jetëshkrimit për një kandidat është mesatarja aritmetike e vlerësimeve e të gjithë anëtarëve*

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesit i cili pretendon se Komisioni i Vlerësimit me rastin e marrjes së vendimit të ankimuar ka bërë shkele të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative gjegjësisht nenin 47 pasi vendimi i lartpërmendur përmban dispozita të pakuptimta dhe kundërthënëse, ka konstatuar se pretendimi i ankuesit është i pa qëndrueshëm pasi që vendimi i atakuar me ankese respektivisht vendimi me numër Nr.RN00012079/02 i datës 05.10.2023 i Komisionit të Pranimit në Komunën Prizrenit, përmban të gjitha elementet e aktit administrativ siç është përcaktuar edhe me nenin 47 paragrafi 1,1.1, 1.2, 1.3 dhe 1.4 të Ligji Nr. 05/L -031 Për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se *Struktura dhe elementet e detyrueshme të aktit administrativ të shkruar 1. Akti administrativ i shkruar përmban: 1.1. pjesën hyrëse, që tregon emrin e organit publik që ka nxjerrë aktin, bazën ligjore, emrin e atij të cilit i drejtohet akti, shënim të shkurtër të lëndës së procedurës dhe datën e nxjerrjes; 1.2. pjesën urdhëruese (dispozitivin), që tregon çfarë është vendosur si dhe afatin, kushtin, detyrimin dhe shpenzimet e procedurës, nëse është i zbatueshëm. Dispozitivi mund të ndahet edhe në më shumë pika. Shpenzimet e procedurës përcaktohen në pikë të veçantë të dispozitivit. 1.3. pjesën arsyetuese (në vijim: arsyetimin); 1.4. pjesën përmbyllëse, që tregon kohën e hyrjes në fuqi të aktit, informatat për mjetet juridike, përfshirë organin publik apo gjykatën ku paraqitet mjeti juridik administrativ apo gjyqësor, formën e mjetit, afatin përkatës dhe mënyrën e llogaritjes së tij (këshillën juridike). Në rast kur ushtrimi i ankesës administrative, sipas ligjit, nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ, pjesa përmbyllëse gjithashtu duhet të përmbajë këtë informacion, si dhe bazën ligjore për një përjashtim të tillë.*

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, theksuar si më sipër vlerëson se Komisioni i Pranimit në Komunën e Prizrenit me nxjerrjen e Vendimit të datës 05.10.2023 ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike, duke vepruar në pajtim me nenin 25 paragrafi 6 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku përcaktohet se: *"Ankesa shqyrtohet nga Komisioni i Pranimit dhe me vendim njoftohet brenda shtatë (7) ditëve nga paraqitja e saj. Nëse rishqyrtimi sjell ndryshimin e renditjes zbatohet përshtatshmërisht ky nen i kësaj Rregulloreje."*

Andaj Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se Komisioni i Pranimit me rastin shpalljes së Njoftimit të datës 29.09.2023 për rezultatet përfundimtare të vlerësimit, dhe përzgjedhjen si kandidatë të suksesshëm të N. Kadolli me gjithsejtë 90.05 pikë të

përgjithshme ka vepruar në pajtim me nenin 34 paragrafi 11 të Ligjit Nr.06/L-144, ku përcaktohet se: "Në përfundim të vlerësimit, kandidatët e vlerësuar me 70 për qind apo më shumë, të pikëve totale të vlerësimit, konsiderohen kandidatë fitues dhe renditen nga Komisioni i pranimit, sipas pikëve të marra, në listën e kandidatëve të suksesshëm." si dhe me nenin 25 paragrafi 1 dhe 2 i Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku përcaktohet se: "1.Përfundimi i konkurrimit dhe shpallja e rezultatit Komisioni i Pranimit, në përfundim të fazës së vlerësimit të kandidatëve, harton dhe miraton aktin e përfundimit të procedurës të konkurimit me fitues që përfshin edhe një listë me vlerësimet përfundimtare të të gjithë kandidatëve. Kandidatët renditen në listë sipas rezultatit të vlerësimit përfundimtar në rendin zbritës. Lista i dërgohet Njësisë Përgjegjëse brenda ditës pasuese të punës nga miratimi i saj. 2.Kandidatët që janë vlerësuar me shtatëdhjetë (70) pikë e më shumë, janë kandidatë fitues." Andaj Komisioni i pranimit me rastin e publikimit të rezultateve për kandidatet fitues për pozitën Inspektor i Tregut në kuadër të Grupit Specialist i Ekonomisë ka hartuar aktin duke përfshirë të gjithë kandidatet fitues ashtu siç është përcaktuar në dispozitat e lartcekura.

Andaj Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se procedurat e konkursit për pranim me numër reference RN00012079, për emrin e grupit "Specialist të Ekonomisë", për pozitën "Inspektor Tregut" në kuadër të Drejtorisë për Inspektorat/ Sektori i Tregut në Komunën e Prizrenit, janë zhvilluar në pajtim me dispozitat ligjore të nenit 34 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrarët Publikë dhe nenit 7 dhe 9 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Kështu që mbështetur në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit

**Këshillë juridike:** Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar Vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIQËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**Lënda me numër A.nr.1370/2023.**

**Ilire Mehmeti-SHAQIRI**

*Procesmbajtëse*

**Malsorë GASHI BAJRAKTARI**

*Kryetare e Kolegjit*



**Vendimi i dorëzohet:**

- Ankuesit
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Prizrenit; dhe
- Arkivot të KPMSHCK- së;